



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Data 28.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Pajisje elektronike dhe kompjuterike” i ndarë sipas loteve:

Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)

Loti 2 - Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres (paisje kompjuterike)

Loti 3 - Pajisje per laboratoret e shkollave

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje kompjuterike dhe furnizime, 30200000-1

Kompjuter portativ, 30213100-6

Kompjuter tablet, 30213200-7

Kompjuter desktop, 30213300-8

Ekrane dhe tastiera kompjuterike, 30231000-7

Printer laser, 30232110-8

Pajisje elektrike dhe aksesore, 31680000-6

Pajisje elektronike, 31710000-6

Pajisje multimedia, 32322000-6

Ruter të rrjetit, 32413100-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 11,602,050 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dy mijë e pesëdhjetë) lek, pa tvsh, i ndarë sipas loteve:

Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj): 7,334,250 (shtatë milionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, pa tvsh.

Loti 2 - Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres (paisje kompjuterike): 88,000 (tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa tvsh.

Loti 3 - Pajisje per laboratoret e shkollave: 4,179,800 (katër milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë, pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1 - PAJISJE ELEKTRONIKE (KOMPJUTER, PRINTER, SKANER, FOTOKOPJE ETJ)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të përlogaritur të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit 1, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2 c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlogaritur të lotit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe gjithashtu bazohet në nenin 42 pika 3 të VKM 285 ku përcaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet

të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës të perlogaritur të lotit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 55 pika 4.b, nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285 ku përcaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, cka sjell një garanci të shtuar për autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në ligj dhe është në përputhje me vlerën e lotit që prokurohet.

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit të cilësive” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij nr.8032/1 Prot, datë 25.08.2026 si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për çertifikatën e mesiperme është konsideruar e nevojshme, duke patur parasysh natyrën dhe vlerën e objektit të prokurimit, për të treguar se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi përmbushin standartin e cilësive për të cilën leshohet kjo çertifikatë me qëllim që autoriteti kontraktor të vertetojë përmbushjen e kontratës në përputhje me standartet e cilësive.

2.3.2 Për të treguar se përmbush specifikimet e kërkuara Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun teknik ose skemat teknike për produktet e mëposhtme:

1	Printer all in one (me ngjyra)
2	Printer all in one (bardh e zi)
3	Kompjutera desktop
4	Kompjuter workstation
6	Aparat fotografik+ lente
7	Laptop advance
10	Kamera profesionale Mirrorless
12	UPS Online
13	Inverter
14	Bateri Lithium
16	Server
17	Core Switch
23	Ekrane informative
24	Skaner profesional

Në katalog apo skedat teknike, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të kërkuara në specifikimet teknike të publikuara me dokumentat e tenderit.

Ne rast se dokumentet e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij nr.8032/1 Prot, date 25.08.2026 si me poshte:

Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, gërma b të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë autoritetit kontraktor që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to.

LOTI 2 - MATERIALE PER FUNKSIONIMIN E PAISJEVE TE ZYRES (PAISJE KOMPJUTERIKE)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të përloqaritur të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit 2, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2 c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 40 % të vlerës të përlllogaritur te lotit qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe gjithashtu bazohet ne nenin nenin 42 pika 3 te VKM 285 ku percaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës te perlllogaritur te lotit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 55 pika 4.b, nenin 42 pika 3 të VKM 285 ku përcaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, cka sjell një garanci të shtuar për autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në ligj dhe është në përputhje me vlerën e lotit që prokurohet.

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësive” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: *Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij nr.8032/1 Prot, datë 25.08.2026 si më poshtë:*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për çertifikatën e mësipërme është konsideruar e nevojshme, duke patur parasysh natyrën dhe vlerën e objektit të prokurimit, për të siguruar se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi përmbushin standardin e cilësive për të cilën lëshohet kjo çertifikatë me qëllim që autoriteti kontraktor të vertetojë përmbushjen e kontratës në përputhje me standartet e cilësive.

LOTI 3 - PAJISJE PER LABORTORET E SHKOLLAVE

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të përlogaritur të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit 3, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2 c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlogaritur të lotit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe gjithashtu bazohet në nenin nenin 42 pika 3 të VKM 285 ku përcaktohet se “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për

tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat": 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës të perlogaritur të lotit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 55 pika 4.b, nenin 42 pika 3 të VKM 285 ku përcaktohet se "Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit."

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, cka sjell një garanci të shtuar për autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo

më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në ligj dhe është në përputhje me vlerën e lotit që prokurohet.

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësive” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij nr.8032/1 Prot, datë 25.08.2026 si më poshtë:

Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për çertifikatën e mesiperme është konsideruar e nevojshme, duke patur parasysh natyrën dhe vlerën e objektit të prokurimit, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi përmbushin standardin e cilësive për të cilën lëshohet kjo çertifikatë me qëllim që autoriteti kontraktor të vërtetojë përmbushjen e kontratës në përputhje me standardet e cilësive.

2.3.2 Për të vërtetuar se përmbush specifikimet e kërkuara Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun teknik ose skedat teknike për produktet e mëposhtme:

Zërat për të cilat duhet të paraqitet katalogu teknik ose skeda teknike:

1	Smartboard 86"
5	Kompjutera desktop
6	Switch 24 porta
7	Router wireless

Në katalog apo skedat teknike, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të kërkuara në specifikimet teknike të publikuara me dokumentat e tenderit.

Në rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij nr.8032/1 Prot, datë 25.08.2026 si më poshtë:

Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, gërma b të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë autoritetit kontraktor që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Llogaritja e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe Kërkesat e tjera të veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin Nr 910 date 31.07.2026.

Argumentimi i specifikimeve Loti I: Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj : Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për pajisje elektronike dhe kompjuterike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me Standardet TIK 2026, të miratuara dhe publikuara nga **Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit (AKSHI)** në dokumentin *Specifikime Teknike “Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyrtar” 2026 (I vlefshëm deri më 31 Dhjetor 2026)*. Këto standarde përcaktojnë kërkesat minimale për pajisjet elektronike dhe infrastrukturorë që përdoren në administratën publike, me qëllim sigurimin e interoperabilitetit, efikasitetit energjetik, sigurisë kibernetike dhe performancës së qëndrueshme. Përcaktimet e përfshira në dosjen teknike janë në përputhje me këto udhëzime standardizuese dhe synojnë unifikimin teknologjik të pajisjeve TIK në nivel institucional, duke garantuar përputhshmëri të plotë me arkitekturën dhe politikën digjitale shtetërore të miratuara nga AKSHI.

Argumentimi i specifikimeve Loti II: Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës (pajisje kompjuterike) Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për pajisje elektronike dhe kompjuterike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Konkretisht:

Specifikimet teknike të këtyre pajisjeve dhe aksesoreve IT janë përcaktuar për të garantuar mirëfunksionimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese teknologjike të rrjetit dhe pajisjeve të Bashkisë, në përputhje me Standardet TIK 2026, të miratuara dhe publikuara nga **Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit (AKSHI)** në dokumentin *Specifikime Teknike “Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyrtar” 2026 (I vlefshëm deri më 31 Dhjetor 2026)* dhe me kërkesat minimale teknike të nevojshme për mjedise institucionale. Elementet si kokat e rrjetit RJ45, kabujt LAN dhe patch cord-et në gjatësi të ndryshme (20 cm deri në 15 m) sigurojnë lidhje të

qëndrueshme dhe fleksibilitet në ndërtimin e rrjetit kabllor, duke mundësuar konfigurim dhe mirëmbajtje efikase të kabinetëve të rrjetit, serverëve dhe stacioneve të punës.

Aksesorët si kabujt HDMI (5m dhe 10m), web kamerat dhe kufjet janë përzgjedhur për të përmbushur nevojat e komunikimit dhe prezantimeve dixhitale në takime, trajnime apo aktivitete publike, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e bashkëpunimit. Po ashtu, USB-të për printerë sigurojnë lidhje të standardizuar dhe të besueshme ndërmjet pajisjeve të printimit dhe stacioneve të punës. Në tërësi, këto specifikime përfaqësojnë nivelin minimal teknik për modernizimin, sigurinë dhe integritetin e rrjetit të brendshëm informatik të Bashkisë Korçë, në përputhje me politikat kombëtare të transformimit digjital.

Argumentimi i specifikimeve Loti III: Pajisje për laboratorët e shkollave Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për pajisje elektronike dhe kompjuterike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me Standardet TIK 2026, të miratuara dhe publikuara nga **Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit (AKSHI)** në dokumentin *Specifikime Teknike “Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyrtar” 2026 (I vlefshëm deri më 31 Dhjetor 2026)*.

Në hartimin e specifikimeve teknike për Lotin 3 “Pajisje për laboratorët e shkollave”, Autoriteti Kontraktor ka mbajtur në konsideratë nevojën konkrete për pajisjen dhe modernizimin e ambienteve laboratorike të institucioneve arsimore, duke përcaktuar kërkesa teknike minimale që sigurojnë funksionalitetin, cilësinë, qëndrueshmërinë dhe përputhshmërinë e pajisjeve me përdorimin e tyre të synuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke pasur si qëllim përshkrimin e karakteristikave minimale teknike dhe funksionale të mallrave që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor, pa orientuar procedurën drejt një prodhuesi, marke apo operatori ekonomik të caktuar. Në këtë kuadër, parametrat teknikë të përcaktuar në dokumentet e tenderit përfaqësojnë kërkesa minimale të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me përdorimin e pajisjeve në laboratorët e shkollave. Ato nuk synojnë identifikimin e një produkti të veçantë, por përcaktimin e nivelit minimal të performancës dhe funksionalitetit që duhet të përmbushë produkti i ofruar.

1. Smartboard 86"

Përcaktimi i një Smartboard-i me madhësi 86" është i lidhur me funksionin që do të kryejë pajisja në ambientet laboratorike dhe arsimore. Madhësia e ekranit siguron shikueshmëri të përshtatshme nga pozicione të ndryshme brenda laboratorit dhe mundëson përdorimin e përbashkët të pajisjes gjatë procesit mësimor.

Kërkesa për funksionin Touch lidhet me nevojën për ndërveprim të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e paraqitur në ekran, duke mundësuar përdorimin e pajisjes për prezantime, materiale didaktike, demonstrime dhe aplikacione interaktive.

Rezolucioni minimal 4K – 3840x2160 përcaktohet për të garantuar cilësi dhe qartësi të lartë të figurës, veçanërisht gjatë paraqitjes së materialeve grafike, skemave, figurave, hartave, materialeve shkencore dhe përmbajtjeve të tjera audiovizive.

Kërkesat për panel IPS, memorie DDR 8 GB, hapësirë ruajtëse 64 GB, lidhje Ethernet/Wi-Fi dhe sistem operativ Android 13 synojnë garantimin e një niveli të përshtatshëm funksional dhe mundësimin e përdorimit të pajisjes si një platformë interaktive dhe e lidhur me rrjetin.

Këto parametra janë përcaktuar si kërkesa minimale funksionale dhe teknike dhe nuk lidhen me një markë apo prodhues të caktuar. Për rrjedhojë, çdo operator ekonomik mund të ofrojë një produkt që përmbush ose tejkalon kërkesat minimale të përcaktuara.

Specifikimet e Smartboard-it të përcaktuara në dokumentacion përfshijnë pikërisht kërkesat për funksionin Touch, panelin IPS, rezolucionin 4K, memorien, hapësirën ruajtëse, fuqinë audio dhe lidhjen në rrjet.

2. Smartboard i lëvizshëm 86"

Për Smartboard-in e lëvizshëm janë përcaktuar të njëjtat kërkesa kryesore funksionale dhe teknike si për Smartboard-in 86", ndërsa kërkesa për Mobile Stand lidhet drejtpërdrejt me karakterin e lëvizshëm të pajisjes.

Përcaktimi i një strukture mbajtëse prej çeliku, me kapacitet mbajtës minimal 110 kg dhe dimensionet e përcaktuara, synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së pajisjes gjatë përdorimit dhe zhvendosjes së saj në ambientet shkollore.

Kjo kërkesë është proporcionale me objektin e kontratës, pasi një pajisje e parashikuar për t'u përdorur në mënyrë të lëvizshme duhet të ketë një bazament të përshtatshëm për peshën dhe dimensionet e ekranit.

Në dokumentacion është përcaktuar shprehimisht kapaciteti minimal mbajtës prej 110 kg për strukturën lëvizëse, duke garantuar kështu sigurinë dhe stabilitetin e pajisjes.

3. Kompjuterët desktop

Kërkesat teknike për kompjuterët desktop janë përcaktuar mbi bazën e performancës minimale të nevojshme për përdorimin e tyre në laboratorët e shkollave.

Përcaktimi i performancës minimale të procesorit në 8500 pikë, sipas një benchmark-u të përcaktuar, synon të garantojë një nivel të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm performance, pa iu referuar një marke ose modeli specifik procesori.

Kërkesa për 8 GB RAM DDR4, SSD minimal 500 GB, si dhe ndërfaqet dhe portat e përcaktuara, sigurojnë kapacitetin minimal të nevojshëm për përdorimin e kompjuterëve në veprimtari mësimore dhe laboratorike.

Përcaktimi i portave USB, RJ-45, audio dhe daljeve të figurës lidhet me nevojën për lidhjen e pajisjeve periferike dhe të pajisjeve të tjera që përdoren në laborator. Kërkesa për Gigabit Ethernet, kartë grafike të integruar, TPM 2.0 dhe sistem operativ të licencuar Windows 11 Professional 64-bit synon sigurimin e një platforme të përshtatshme për përdorim institucional, administrim, siguri dhe ndërveprim me pajisjet e rrjetit dhe ato periferike. Gjithashtu, përcaktimi i monitorit me madhësi minimale 21", rezolucion 1920x1080 dhe parametra minimalë të performancës së ekranit lidhet me nevojën për një paraqitje të qartë të materialeve mësimore dhe aplikacioneve të përdorura. Kërkesa për garanci 3 vjet synon garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të pajisjeve dhe mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor gjatë periudhës së përdorimit të tyre. Në mënyrë të veçantë, përdorimi i kriterit të benchmark-ut për procesorin nuk synon të përcaktojë një prodhues të caktuar. Përkundrazi, ai lejon krahasimin e produkteve të ndryshme mbi bazën e performancës së tyre, duke krijuar mundësi që të ofrohen zgjidhje teknike nga prodhues të ndryshëm.

4. Switch 24 porta

Përcaktimi i një Switch Gigabit të pamenaxhueshëm me 24 porta lidhet me nevojën për krijimin e infrastrukturës së komunikimit ndërmjet pajisjeve të laboratorit dhe lidhjen e tyre në rrjet. Numri minimal prej 24 portash përcaktohet mbi bazën e nevojës për lidhjen e një numri të konsiderueshëm pajisjesh në të njëjtin ambient, duke mundësuar zgjerimin dhe përdorimin e infrastrukturës së rrjetit pa nevojën e pajisjeve shtesë në mënyrë të menjëhershme. Kërkesa për standardet IEEE 802.3 dhe IEEE 802.3ab 1000BASE-T siguron përputhshmërinë me standardet përkatëse të komunikimit dhe shpejtësinë Gigabit të transmetimit. Kërkesat janë të shprehura në terma teknikë dhe funksionalë dhe nuk identifikojnë një prodhues apo model të caktuar.

5. Router Wireless

Kërkesa për router wireless të klasës minimale AX3000, me mbështetje të standardeve IEEE 802.11a/b/g/n/ac/ax, lidhje Gigabit WAN dhe LAN dhe funksionim në dy breza 2.4 GHz dhe 5 GHz, lidhet me nevojën për sigurimin e komunikimit pa tela dhe lidhjes së pajisjeve të laboratorit me rrjetin. Përcaktimi i parametrave minimalë të transferimit, standardeve të rrjetit, mënyrave të operimit dhe karakteristikave të sigurisë synon garantimin e një infrastrukture të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim arsimor. Këto kërkesa janë të lidhura me funksionin e pajisjes dhe me nevojën për ndërveprim me pajisjet e tjera të laboratorit. Ato nuk kanë për qëllim të kufizojnë konkurrencën, por të përcaktojnë nivelin minimal të performancës që duhet të ofrohet. Dokumenti përcakton, ndër të tjera, klasën minimale AX3000, standardet Wi-Fi, portat Gigabit, funksionimin Dual Band 2.4 GHz/5 GHz dhe kërkesat e sigurisë.

6. Mouse dhe tastierë

Mouse dhe tastiera janë pajisje periferike të nevojshme për funksionimin dhe përdorimin e kompjuterëve desktop dhe pajisjeve kompjuterike të laboratorëve. Përcaktimi i tyre si pjesë e pajisjeve të laboratorit lidhet drejtpërdrejt me nevojën që kompjuterët të jenë të kompletuar dhe të gatshëm për përdorim nga nxënësit dhe stafi mësimor. Për tastierën dhe mouse-in duhet të respektohen kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike, duke lejuar ofrimin e produkteve ekuivalente që përmbushin funksionin dhe karakteristikat minimale të kërkuara.

7. Pajisje elektrike (priza, tapa, kabuj, vidha, tenie, kuti shpërndarje, grapeta, etj)

Pajisjet elektrike të parashikuara në preventiv janë të lidhura me nevojën për furnizimin dhe funksionimin e sigurt të pajisjeve elektronike dhe kompjuterike të laboratorëve.

Në përfundim, specifikimet teknike të Lotit 3 janë hartuar duke u mbështetur në kërkesat reale funksionale të laboratorëve të shkollave dhe në nevojën për sigurimin e pajisjeve të përshtatshme për përdorim arsimor. Parametrat e përcaktuar për Smartboard-et, kompjuterët, pajisjet e rrjetit dhe pajisjet periferike përbëjnë kërkesa minimale të performancës, funksionalitetit, sigurisë dhe përputhshmërisë, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me qëllimin e saj. Në hartimin e tyre është shmangur përcaktimi i markave, modeleve apo prodhuesve të veçantë. Parametrat janë formuluar në mënyrë që të mundësojnë ofrimin e produkteve nga prodhues dhe operatorë ekonomikë të ndryshëm, për sa kohë që produktet e ofruara përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, specifikimet teknike nuk synojnë dhe nuk sjellin përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga konkurrimi, por synojnë të garantojnë që Autoriteti Kontraktor të marrë pajisje që plotësojnë nivelin minimal të cilësisë dhe performancës së nevojshme për realizimin e qëllimit të kontratës.

Në çdo rast ku dokumentet e tenderit i referohen një standardi, norme teknike apo karakteristike që mund të lidhet me një zgjidhje të caktuar teknike, referenca duhet të kuptohet dhe zbatohet në përputhje

me parashikimet e ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, duke lejuar zgjidhje ekuivalente që përmbushin kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara.

Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Në të gjitha raste ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë pjesë e dokumentave të tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT